

URDHËRESË
Nr.3, datë 25.5.1990

PËR KREDINË BANKARE NË VALUTË TË LIRË

Këshilli i Ministrave nxjerr këtë

URDHËRESË:

KREU I
DHËNIA E KREDISË BANKARE NË VALUTË TË LIRË

Neni 1

Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatshkurtër në valutë të lirë ndërmarrjeve që merren me tregti të jashtme, ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore që prodhojnë për eksport, ministrive, insitucioneve e ndërmarrjeve të tjera të interesuara, kur dhënia e kësaj kredie është me efektivitet ekonomik.

Neni 2

Banka e Shtetit Shqiptar jep kredi afatshkurtër në valutë të lirë për këto qëllime:

- a) Për të shfrytëzuar koniukturën e favorshme të çmimeve të importit, sidomos të atyre me karakter stinor, dhe për të blerë e rishitur mallra me fitim në valutë të lirë.
- b) Për të stimuluar shtimin e prodhimit të mallrave për eksport ose të artikujve të rinj, kur kanë treg shitjeje në valutë të lirë.
- c) Për të blerë disa mallra importi të konsumit të gjerë, shitja e të cilave krijon të ardhura suiplemetare në valutë.
- ç) Për të blerë mjete, makineri, pjesë ndërrimi e materiale importi që shërbejnë për rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat ndikojnë në shtimin e të ardhurave në valutë të lirë.
- d) Për linja, makineri e pajisje që përmirësojnë provesin teknologjik të prodhimit në degë të ndryshme të ekonomisë, nëpërmjet të cilave kursehen fondet valute të importit.
- dh) Për raste të tjera, që do të gjykohen me leverdi nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Neni 3

Banka e Shtetit Shqiptar, në bazë të dokumentacionit që ndërmarrjet dhe ministritë depozitojnë në të, jep kredi afatgjatë në valutë të lirë për investime në objekte, linja, makineri, pajisje etj, kur këto kanë leverdi ekonomike, krijohen të ardhura suplementare në valutë ose ka efekte pozitive në pakësimin e shpenzimeve në valutë.

Neni 4

Ndërmarrjeve që përfitojnë kredi në valutë, kur është rasti, u jepet edhe kredi bankare në lekë, për të përballuar kundërvleftën e valutës dhe shpenzimet e tjera të brendshme.

Neni 5

Burimet e përballimit të kredisë në valutë janë: mjetet e veta të bankës, ato që i vihen në dispozicon nga veprimtaria e saj nëpërmjet marrëveshjeve me bankat e firmat e huaja etj.

KREU II
KTHIMI I KREDISË NË VALUTË DHE INTERESAT BANKARE

Neni 6

Kredia afatshkurtër në valutë jepet me afat kthimi jo më tepër se 1 vit, kurse ajo afatgjatë deri në 7 vjet.

Neni 7

Shlyerja e kredisë në valutë të lirë e në lekë bëhet sipas afateve të caktuara nga banka.

Neni 8

Për kreditë që jep në valutë Banka e Shtetit shqiptar zbaton interesa, komisione e shpenzime bankare.

Neni 9

Banka e shtetit Shqiptar nuk jep kredi të tjera në valutë, në rast se nuk është kthyer në afat kredia e mëparshme. Për shumën e kredive të pakthyera në afat zbatohen interesa më të larta.

Kur ndërmarja, institucioni a kooperative bujqësore nuk është në gjendje të kthejë kredinë në valutë, shuma përkatëse merret nga fondet e importit të tyre ose të ministrisë nga varen.

Neni 10

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së shtetit shqiptar ngarkohet të lëshojë udhëzimin përkatës për zbatimin e dispozitave të kësaj urdhërese.

Neni 11

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.24, datë 13.1.1988 “Për kredinë bankare në valutë”, shfuqizohet.

Neni 12

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI